Emri i projektit: Rinia, Punësimi dhe Aftësimi dhe Arsimi Profesional (YES)
Autorizuar nga: Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)
Rajoni i projektit: Republika e Kosovës
Agjencia implementuese: Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH
Kohëzgjatja: 01/2017 – 12/2020
Partnerët kryesorë politik: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)
Volume: 12.000.000 €

Objektivi

Përmirësimi i punësimit të të rinjve kosovarë të moshës 15 deri në 35 vjeç dhe grupeve të cenueshme, përfshirë migrantët e kthyer, duke ofruar perspektiva në tregun e punës në Kosovë.

Qasja e projektit

Projekti zbaton qasjen nga lartë-poshtë, duke adresuar fillimisht akterët në nivel lokal, siç janë institucionet për arsim dhe aftësim profesional, zyrat publike të punësimit, qendrat rinore dhe bizneset. Projekti synon fuqizimin e kapaciteteve të ministrive relevante dhe agjencive të tyre (AAAPARR/APRK) duke mbështetur politikat, shërbimet dhe ofertat e tyre për të rinjtë dhe grupet e cenueshme.

Rezultatet e projektit

1. Zbatohen masat e tregut të punës të përshtatura për nevojat e të rinjve dhe nevojat e punëdhënësve.
2. Zbatohen dhe përdoren masat e tregut të punës të përshtatura me nevojat e grupeve të cenueshme (veçanërisht minoritetet, të kthyerit) dhe nevojat e punëdhënësve.
3. Cilësia e përmirësuar e arsimit dhe aftësimit profesional për të rinjtë.
4. Model i replikueshëm për kualifikim dhe njohje të përshtatur me profesionet mungesë në Kosovë dhe Gjermani, i zhvilluar dhe i prezantuar tek vendimmarrësit në të dyja vendet.

Aktivitetet kryesore të projektit YES në mbështetjen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT)

Gjeni më poshtë disa nga aktivitetet kryesore që YES është duke i zbatuar në mbështetje të MASHT-it në nivel qendror dhe lokal në fushën e arsimit dhe aftësimit profesional:

- ✓ Anketa për identifikimin dhe përzgjedhjen e shkollave të AAP pilot të projektit YES, profilet profesionale dhe pilot lokacionet për masat për zhvillimin e kapaciteteve
- ✓ Mbështetja për zhvillimin e mëtejshëm të standardeve dhe profileve të përzgjedhura profesionale (p.sh. në fushat e ndërtimit, shitjes me pakice dhe shitjes me shumicë)
- ✓ Zhvillimi i kapaciteteve për mësimdhënësit e praktikës profesionale në shkollat profesionale në lidhje me kurrikulën e re bërthamë për AAP
- ✓ Asistencë teknike për përmirësimin e bashkëpunimit të vendeve të ndryshme të mësim nxënies – ndërmjet shkollave të AAP-së, kompanive trajnuese dhe QAP-ve – për fuqizimin e qasjeve bashkëpunuese të arsimit dhe aftësimit profesional

- ✓ Asistenca teknike për rishikimin e formulës së financimit për profilet e përzgjedhura profesionale
- ✓ Zhvillimi i standardit për trajnerët brenda kompanisë, master trajnerët dhe zhvillimin e trajnerëve brenda kompanisë, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e sektorit privat (dhomat dhe shoqatat industriale) dhe bizneset individuale pjesëmarrëse.

Për më shumë informacione, vizitoni ueb-faqen tonë: www.yesforkosovo.org